

E kanë varrosur në varrezat e Berishës/ Beriša [Malishevë/Mališevo].

Burimet: SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 8,9, FDH-33372; SMIP, *Terroristički...*, III, 563; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Arton (Shaip) Haxhiu

(26.06.1976, shqiptar nga Pokleku/Poklek, komuna e Glllogocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Artoni aderoi në UÇK në fillim të vitit 1998. Trajnimin ushtarak e ka kryer në Obri të Epërme/Gornje Obrinje. Kur forcat serbe e sulmuan **Poklekun/Poklek** më 26.06.1998, familja e Artonit ka kaluar në Prishtinë/Priština, ndërkaq ai ka mbetur në fshat me bashkëluftëtarët e tij. Babai dhe motra e tij e kanë vizituar atë më 27.11.1998. Pas darkës së përbashkët me të atin dhe motrën, Artoni shkoi në pozicionet e UÇK-së. Në mëngjesin e datës **28.11.1998**, Artonin e ka qëlluar një plumb snajperi, përderisa ishte në pozicionin e vet. Bashkëluftëtarët e kanë çuar menjëherë në spitalin privat në *Vranjevc/Vranjevac* në Prishtinë/Priština. Pas pak, ai dha shpirt nga plaga e rëndë. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Artanin në varrezat e Pokleku/Poklek.

Burimet: deklarata S.H, FDH-31844; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Xhafer (Liman) Qorri

(18.01.1947, shqiptar nga Glllogoci/Glogovac, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë, pesë fëmijë)

Nazif (Sahit) Mulaj

(5.05.1956, shqiptar nga Tërsteniku/Trstenik, komuna e Glllogocit/ Glogovac, punëtor, katër fëmijë)

Brahim (Isuf) Musliu

(17.01.1958, shqiptar nga Shterbullova/Štrubulovo, komuna e Glllogocit/Glogovac, punëtor, pesë fëmijë)

Xhaferi ka filluar së punuari si polic në vitin 1968. Ishte i martuar me një serbe. I kishin pesë fëmijë. Jetonte në **Glllogoc/Glogovac**,

edhe në *Mëhallën Qorri*, e cila gjendej në mes të stacionit policor dhe fabrikës *Ferronikel*. Në datën 11.11.1998, pjesëtarë të UÇK-së e sulmuan shtëpinë e tij me minahedhës dhe armë automatike. Njëherësh u sulmua edhe stacioni policor i Glllogocit/Glogovac.

Nazifi dhe Brahimi punonin në trafo-stacionin kryesor për shpërndarjen e rrymës elektrike në Glllogoc/Glogovac. Që të dy ishin electricist me profesion. Nazifi me familje jetonte në *Mëhallën Mulaj* në fshatin Tërstenik/Trstenik, ndërsa Brahimi në Shterbullovë/Štrubulovo, në periferi të qytetit.

Në orët e hershme të mëngjesit, në datën **11.12.1998**, Nazifi dhe Brahimi shkuan në punë. Po ashtu, edhe Xhaferi shkoi në punë. Pas disa orësh u dëgjuan të shtëna nga drejtimi i trafo-stacionit. Policia ka bllokuar menjëherë qasjen ndaj objektit. Po atë ditë, MPB-ja e Serbisë ka bërë të ditur se pjesëtarë i saj, Xhafer Qorri, ka pësuar gjatë sulmit në trafo-stacion dhe se me këtë rast u vranë edhe dy punëtorë, Nazim Mulaj dhe Brahim Musliu. Familjarët e Nazimit dhe Brahimit kanë dëgjuar më vonë se policët vet e kanë vrarë Xhafer Qorrin dhe se më atë rast kanë pësuar edhe Brahimi dhe Nazifi. Trupat e Xhaferit, Nazifit dhe Brahimit policia i ka çuar për obduksion në spitalin e Prishtinës/Priština. Të nesërmen, më 12.12.1998, familjet i kanë marrë trupat e të vrarëve. Nazifi u varros në varrezat e *Mëhallës Mulaj* të Tërstenikut/Trstenik; Brahimi në varrezat e fshatit të lindjes së Shterbullovës/Štrubulovo, ndërsa Xhaferi në varrezat e *Mëhallës Qorraj* në Glllogoc/Glogovac. Pas përfundimit të luftës, më 23.10.2000, familjarët e Nazifit i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Tërstenik/Trstenik.

Burimet: deklarata E.Q, FDH-31846; deklarata X.M, FDH-15616; deklarata F.M, FDH-19760; deklarata Xh.Q, FDH-8892; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Terroristički...*, III, 942; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 71.
